

ALBDESIGN PSP SH.P.K

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Sëbashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

Përmbajtja

| | Faqe |
|----------------------------------|--------|
| Raporti i Audituesit të Pavarur | 1 |
| Pasqyrat Financiare | |
| Pasqyra e pozicionit financiar | 2 |
| Pasqyra e performancës | 3 |
| Pasqyra e ndryshimeve në kapital | 4 |
| Pasqyra e fluksit të parasë | 5 |
| Shënime mbi pasqyrat financiare | 6 - 17 |

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Ortakeve të Shoqërisë Albdesign PSP sh.p.k

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë **Albdesign PSP sh.p.k** (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2015, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të **Albdesign PSP sh.p.k** më datën 31 dhjetor 2015, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.



20 prill 2016

Albdesign PSP sh.p.k
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2015

| | Shënime | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|---|---------|------------------------|
| AKTIVET | | |
| Aktive afatshkurtra | | |
| Mjete monetare | 4 | 5,170,827 |
| Llogari të arkëtueshme tregtare | 5 | 40,305,919 |
| Inventari | 6 | 4,082,093 |
| Total aktive afatshkurtra | | 49,558,839 |
| Aktivët afatgjatë | | |
| Aktive afatgjatë materiale | 7 | 4,614,659 |
| Total aktive afatgjatë | | 4,614,659 |
| Total aktive | | 54,173,498 |
| DETYRIMET | | |
| Detyrime afatshkurtra | | |
| Llogari të pagueshme tregtare | 8 | 39,718,469 |
| Detyrime tatimore | 9 | 2,148,298 |
| Të tjera detyrime | 10 | 273,200 |
| Total detyrime afatshkurtra | | 42,139,967 |
| Detyrime afatgjatë | | |
| Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura | 11 | 3,985,840 |
| Total detyrime afatgjatë | | 3,985,840 |
| Totali i detyrimeve | | 46,125,807 |
| KAPITALI | | |
| Kapitali i nënshkruar | | 100,000 |
| Fitimi i ushtrimit | | 7,947,691 |
| Total kapitali | 12 | 8,047,691 |
| Totali i kapitalit dhe detyrimeve | | 54,173,498 |

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albdesign PSP sh.p.k
Pasqyra e Performancës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

| | Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 |
|--|-----------|---|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 13 | 71,155,327 |
| Të ardhura të tjera të shfrytëzimit | 14 | 44,061 |
| Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | | (56,382,097) |
| 1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | 15 | (55,814,938) |
| 2) Të tjera shpenzime | 16 | (567,159) |
| Shpenzime te personelit | 17 | (5,295,656) |
| 1) Paga dhe shpërblime | | (4,579,318) |
| Shpenzime të sigurimeve | | |
| 2) shoqërore/shëndetsore | | (716,338) |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 7 | (157,026) |
| Të ardhura të tjera | | - |
| Shpenzime financiare | | - |
| Fitimi/humbja para tatimit | | 9,364,609 |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | 18 | (1,416,918) |
| 1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | | (1,416,918) |
| Fitimi/humbja e vitit | | 7,947,691 |
| Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin: | | - |
| Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin | | - |
| Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin | | 7,947,691 |

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albdesign PSP sh.p.k

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

| | Kapitali I nënshkruar | Fitim / Humbja e vitit | Totali |
|---|--------------------------|---------------------------|------------------|
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014 | - | - | - |
| Fitimi / Humbja e vitit | | 7,947,691 | 7,947,691 |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | 100,000 | | 100,000 |
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015 | 100,000 | 7,947,691 | 8,047,691 |

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 -17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues më 27 janar 2016 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:



Z. Elvis Sula
Administrator

ALBDESIGN PSP

Rr. Çerçiz Topulli, 17 - Kashar, Tiranë
NIPT: L51819005Q

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

| Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 |
|--|---|
| Flukset e parasë nga aktivitetet operative | |
| Fitim / Humbja e vitit | 7,947,691 |
| Rregullimet për shpenzimet jomonetare: | |
| Shpenzimet financiare jomonetare | 5,965 |
| Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar | 1,416,918 |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 157,026 |
| Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera | (40,305,919) |
| Rënie/(rritje) në inventarë | (4,082,093) |
| Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme | 40,470,481 |
| Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit | 252,568 |
| Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit | 5,862,637 |
| Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit | |
| Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale | (4,771,685) |
| Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit | (4,771,685) |
| Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit | |
| Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar | 100,000 |
| Hua të arkëtuara | 3,985,840 |
| Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit | 4,085,840 |
| Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare | 5,176,792 |
| <i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i> | (5,965) |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor | 5,170,827 |

4

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

"Albdesign PSP" sh.p.k (Shoqëria) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë QKR me datë 19/06/2015, me NIPT L51819005Q, në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lek (njëqindmijë) i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 100,000 lekë, me aksioner të vetëm z. Elvis Sula.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shitje shtypshkrime të ndryshme, punime grafike dhe dizenjime. Viti 2015 është viti i parë i aktivitetit të kompanisë. Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të jetë pa ndërprerje mbi 10 vjet.

Selia e shoqërisë është në adresën: Lagjja Mëzezë, Rruga "Çerçiz Topulli", Nr.17, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 5, Kashar Tiranë. Shoqëria është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me NIPT L51819005Q.

Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria kishte 33 punonjës.

1. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Shoqëria e ka filluar aktivitetin e saj në korrik 2015 dhe për pasojë nuk ka të dhëna krahasuese për vitin 2014.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 është detajuar si më poshtë:

| Kursi i këmbimit | 31 dhjetor 2015 |
|------------------|-----------------|
| Euro/LEK | 137.28 |
| USD/LEK | 125.79 |
| GBP/LEK | 186.59 |

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën fillestare.

Zhvlërimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlëruar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlërim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlërim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlërimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlërimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlërimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlërimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 është si më poshtë:

| Kategoria e aktiveve | Metoda e Amortizimit | Norma e Amortizimit |
|----------------------|----------------------|---------------------|
| Makineri dhe pasije | Vlera e mbetur | 20 % |
| Mjete transporti | Vlera e mbetur | 20 % |
| Paisje informatike | Vlera e mbetur | 25% |
| Të tjera | Vlera e mbetur | 20 % |

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm.

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

4. MJETE MONETARE

Gjendja e mjeteve monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|-------------------------|-------------------------|
| Mjete monetare në bankë | 5,167,361 |
| Mjete monetare në arkë | 3,466 |
| | <u><u>5,170,827</u></u> |

5. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015, paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|----------------|--------------------------|
| Klientë vendas | 40,305,919 |
| | <u><u>40,305,919</u></u> |

6. INVENTARI

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|--------------|-------------------------|
| Lëndë e parë | 4,082,093 |
| | <u><u>4,082,093</u></u> |

7. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

| Përshkrimi | Makineri dhe pajisje | Mjete transporti | Kompjuter | Të tjera | Totali |
|-------------------------------|-----------------------|-------------------------|----------------------|----------------------|-------------------------|
| Gjëndja më 31 dhjetor 2014 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shtesa | 325,442 | 4,309,005 | 99,071 | 38,167 | 4,771,685 |
| Gjëndja më 31 dhjetor 2015 | <u>325,442</u> | <u>4,309,005</u> | <u>99,071</u> | <u>38,167</u> | <u>4,771,685</u> |
| Amortizimi i akumuluar | | | | | |
| Gjëndja më 31 dhjetor 2014 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Amortizimi i vitit | 10,848 | 143,634 | 0 | 2,544 | 157,026 |
| Gjëndja më 31 dhjetor 2015 | <u>10,848</u> | <u>143,634</u> | <u>0</u> | <u>2,544</u> | <u>157,026</u> |
| Vlera neto kontabël | | | | | |
| Gjëndja më 31 dhjetor 2014 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjëndja më 31 dhjetor 2015 | <u><u>314,594</u></u> | <u><u>4,165,371</u></u> | <u><u>99,071</u></u> | <u><u>35,623</u></u> | <u><u>4,614,659</u></u> |

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

8. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015, paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|-------------------|--------------------------|
| Furnitorë vendas | 39,213,677 |
| Furnitorë të huaj | 504,792 |
| | <u>39,718,469</u> |

9. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2015, paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|---|-------------------------|
| Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore | 195,745 |
| Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi | 5,200 |
| Tatim në burim | 2,065 |
| Tatim fitimi | 1,416,918 |
| TVSH për t'u paguar | 528,370 |
| | <u>2,148,298</u> |

10. DETYRIMET TE TJERA

Detyrimet e tjera të cilat paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe të tjera detyrime, më 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|--------------------------|------------------------|
| Detyrime ndaj personelit | 244,198 |
| Dietat e punonjësve | 8,370 |
| Të tjera detyrime | 20,632 |
| | <u>273,200</u> |

11. LLOGARI TË PAGUESHME NDAJ PALËVE TË LIDHURA

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura paraqesin financimet e ortakut, dhe më 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|--------------------|-------------------------|
| Finacim Elvis Sula | 3,985,840 |
| | <u>3,985,840</u> |

12. KAPITALI

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 100,000 Leke.

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

13. TË ARDHURA

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 |
|--|---|
| Të ardhura nga shitja e produktit të gatshëm | 58,244,958 |
| Të ardhura nga kryerja e shërbimeve | 1,077,228 |
| Të ardhura nga shitja e mallrave | 11,833,141 |
| | 71,155,327 |

Tabela më poshtë përfaqëson rakordimin e të ardhurave me deklaratimet mujore të TVSH-së:

| Rakordimi ndërmjet të ardhurave në PASH dhe atyre të deklaruar në FDP | Për vitin e mbyllur më dhjetor 2015 |
|--|--|
| Shitje total të deklaruar në FDP TVSH | 71,155,327 |
| Autofatura | - |
| Shitje të dekaluara në FDP që janë të ardhura në PASH | 71,155,327 |
| Shitje produkte të gatshme | 58,244,958 |
| Shitje mallrash e materialesh | 11,833,141 |
| Shitje shërbime | 1,077,228 |
| Të ardhura të deklaruar në PASH që janë deklaruar shitje në FDP | 71,155,327 |
| Fitim nga këmbimet valutore | 55,601 |
| Total të ardhura të deklaruar në FDP e Tatim Ftimit | 71,210,928 |

14. TË ARDHURA TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe të ardhura të tjera jo-kryesore dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 |
|------------------------------|---|
| Fitime nga këmbime valutore | 55,601 |
| Humbje nga këmbimet valutore | (11,540) |
| | 44,061 |

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

15. MATERIALE TË PARA DHE TË KONSUMUESHME

Tabela më poshtë përfaqëson një detajim të materialeve të para të konsumueshme dhe të shërbimeve:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u> |
|---|---|
| Kosto e lëndëve të para e materialeve | 34,951,717 |
| Kosto e mallrave | 11,387,680 |
| Energji elektrike, uje | - |
| Nënkontraktorë | 2,343,999 |
| Mirëmbajtje dhe riparime makineritë dhe fabrika | 103,868 |
| Qira infrastrukturë prodhimi | 7,027,674 |
| | <u><u>55,814,938</u></u> |

16. SHPENZIME TË TJERA

Tabela më poshtë përfaqëson një detajim të shpenzimeve të tjera:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u> |
|---|---|
| Taksa vendore | 11,820 |
| Prime të sigurimit | 15,300 |
| Shpenzime administrative noteriale | 3,700 |
| Kanceleri | 105,583 |
| Shërbime postare | 4,460 |
| Komisione bankare | 43,579 |
| Shpenzime për kontrolle teknike e çertifikime | 277,212 |
| Shpenzime udhëtimi e dieta | 91,740 |
| Të tjera | 13,765 |
| | <u><u>567,159</u></u> |

17. SHPENZIME PERSONELI

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u> |
|---|---|
| Shpenzime për paga | 4,579,318 |
| Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore | 716,338 |
| | <u><u>5,295,656</u></u> |

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

18. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin është llogaritur si më poshtë:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u> |
|---|---|
| <i>Fitimi para tatimit</i> | 9,364,609 |
| Shpenzime të panjohura (si më poshtë) | 81,509 |
| Shpenzime pa faturë të regullt tatimore | 81,509 |
| <i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i> | 9,446,118 |
| <i>Tatim fitimi @15%</i> | 1,416,918 |
| Fitimi i vitit | <u><u>7,947,691</u></u> |

19. PALËT E LIDHURA

Këto përfaqësojnë transaksionet me palët e lidhura, si njësitë e kontrolluara, të kontrolluara bashkarisht ose kanë një ndikim të konsiderueshëm nga palët e tilla. Politikat e tarifimit dhe kushtet e këtyre transaksioneve janë aprovuar nga manaxhimi.

Balancat me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e pozicionit financiar paraqitet si më poshtë:

| Bilanci kontabël | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|--|------------------------|
| Të pagueshme ndaj palëve të lidhura | |
| Orkaku Elvis Sulo Sulo | 3,985,840 |
| | <u>3,985,840</u> |

20. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2015, Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

21. NGJARJE PAS BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.